

REKOMANDIM PËR PROAKTIVITET

Shpenzimi i parave publike imponon një detyrim për funksionimin transparent të institucioneve dhe arsyetimin e fondeve të shpenzuara. Për një administratë efikase dhe transparente, zbatohet rregulla e përgjithshme: vlera për fondet publike. Shërbimet e administratës publike kanë vlerë nëse ato janë ofruar në kohë, në mënyrë efikase, ashtu që do të jenë të dukshme, të qartë dhe lehtësisht të arritshme për të gjithë shfrytëzuesit. Qëllimi i shpalljes proaktive të informatave me karakter publik është të krijohet një administratë publike efikase, efektive dhe transparente në pajtim me parimet e hapësirës administrative Evropiane dhe të elementeve themelore të qeverisjes së mirë. Proaktiviteti tregon indirekt nevojën për të rritur nivelin e transparencës të poseduesit e informacioneve me karakter publik.

Vlera e veçantë e transparencës së administratës publike është në integritetin e saj. Vetëm një administratë publike transparente forcon besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore në atë masë që vetëm një qeveri transparente paraqet një pushtet legjitim. Transparenca e administratës është e rëndësisë thelbësore, edhe atë:

- justifikon ekzistencën e aparatit administrativ;
- sforcon besimin e qytetarëve në përfaqësuesit e pushtetit të zgjedhur në mënyrë legjitime;
- kursen resurse
- nxit krijimin e një shoqërie të diturisë dhe kompetencave, dhe
- institucione të hapura dhe shoqëri më demokratike

Një nga mënyrat e arritjes së transparencës të administratës publike është me publikimin proaktiv të informacioneve dhe komunikimit të institucioneve në web-faqet e tyre zyrtare.